



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA
MINISTËR SHTETI PËR PUSHTETIN VENDOR
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E VETËQEVERISJES VENDORE

PROCEDURA STANDARDE VEPRIMI NË KUADËR TË GBP 2026

I. QËLLIMI

Procedura Standarde Veprimit (PSV) përcakton hapat, përgjegjësitë dhe dokumentacionin që do të ndiqen gjatë zhvillimit të mbledhjes së Komisionit të Vlerësimit të Aplikimeve (KVA) për Grantin e Bazuar në Performancë (GBP) 2026.

PSV-ja synon të sigurojë një proces të strukturuar, transparent dhe të dokumentuar të vlerësimeve, duke garantuar që të gjitha procedurat administrative që lidhen me procesin e vlerësimit të trajtohen në mënyrë të njëtrajtshme dhe në përputhje me Udhëzimin për GBP 2026.

II. HAPJA DHE KONSTITUIMI I MBLEDHJES

Mbledhja konstituohet nga Kryetari i Komisionit të Vlerësimit të Aplikimeve, i cili perfaqëson Ministrin e Shtetit për Pushtetin Vendor dhe të pranishëm janë anëtarët e KVA-së sipas shkresave përcjellëse të institucioneve. Kryetari ka të drejtë të vendosë konstituimin e KVA në mbledhjen e pare, pasi verifikon pjesëmarrjen e anëtarëve, referuar edhe listëprezencave të administruara nga Sekretariati Teknik.

Dokumentacioni: Lista e anëtarëve të KVA, Listëprezencat (**Aneksi Nr.1**)

Rezultati: Mbledhja e parë e KVA.

III. PREZANTIMI I QËLLIMIT DHE PROCEDURAVE TË PUNËS

Në vijim, AMVV në rolin e Sekretariati Teknik do të prezantojë mekanizmin e GBP 2026 dhe mënyrën e zhvillimit të procesit të vlerësimit. Anëtarëve të KVA-së do t'u paraqiten procedurat standarte të veprimit për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikimeve, si dhe dokumentacioni dhe kriteret përkatëse të përcaktuara në Udhëzimin për GBP 2026.

Përgjegjës: Sekretariati Teknik.

Dokumentacioni: Agjenda dhe Udhëzimi për GBP 2026 (**Aneksi Nr.2**).

Rezultati: Dakordësimi mbi agjendën dhe procedurat e punës.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA
MINISTËR SHTETI PËR PUSHTETIN VENDOR
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E VETËQEVERISJES VENDORE

IV. NËNSHKRIMI I DEKLARATAVE NGA ANËTARËT E KVA-së

Në vijim të mbledhjes, anëtarët e KVA-së do të nënshkruajnë deklaratat përkatëse, në përputhje me kërkesat procedurale të procesit të vlerësimit.

Deklaratat e nënshkruara do të administrohen nga Sekretariati Teknik si pjesë e dokumentacionit zyrtar të procesit.

Përgjegjës: Anëtarët e KVA-së / Sekretariati Teknik.
Dokumentacioni: Deklaratat e anëtarëve të KVA (**Aneksi Nr.3 dhe Nr.4**).
Rezultati: Deklaratat e nënshkruara dhe të administruara.

V. PREZANTIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT

Sekretariati Teknik do të prezantojë procesin e ndjekur për administrimin dhe shqyrtimin e dokumentacionit të paraqitur nga bashkitë. Në këtë fazë do të paraqiten materialet e përgatitura për vlerësim, përfshirë Memot, tabelat në Excel dhe dokumentacionin mbështetës të administruar gjatë procesit.

Përgjegjës: Sekretariati Teknik.
Dokumentacioni: Memo, tabela Excel dhe dokumentacioni i bashkive (**Aneksi Nr.5 dhe Nr.6**).
Rezultati: Dokumentacioni i procesit i prezantuar për shqyrtim nga KVA

VI. SHQYRTIMI DHE DISKUTIMI I REZULTATEVE PARAPRAKE

Pas prezantimit të verifikimeve nga Sekretariati Teknik, anëtarët e KVA-së do të shqyrtojnë dhe diskutojnë rezultatet e aplikimit të bashkisë mbi treguesin përkatës.

Diskutimi do të fokusohet në vlerësimin e bazuar në plotësinë e dokumentacioneve si dhe kritereve përkatëse të cilësisë, apo të çdo çështjeje tjetër që mund të ndikojë në vlerësimin e bashkive.

Çdo koment, vërejtje apo kërkesë për sqarim do të dokumentohet nga Sekretariati Teknik.

Përgjegjës: Anëtarët e KVA-së / AMVV.
Rezultati: Komente, vërejtje dhe sqarime të dokumentuara.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA
MINISTËR SHTETI PËR PUSHTETIN VENDOR
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E VETËQEVERISJES VENDORE

VII. TRAJTIMI I RASTEVE TË VEÇANTA

Gjatë shqyrtimit të rezultateve, KVA-ja mund të identifikojë raste të veçanta që kërkojnë verifikim ose sqarime shtesë. Në këto raste, Sekretariati Teknik do të paraqesë evidencat dhe dokumentacionin përkatës, ndërsa KVA-ja do të shqyrtojë rastin dhe do të përcaktojë mënyrën e trajtimit të tij në përputhje me procedurat e përcaktuara.

Përgjegjës: Anëtarët e KVA-së / AMVV.
Dokumentacioni: Evidenca dhe dokumentacion shtesë.
Rezultati: Rastet e veçanta të shqyrtuara dhe të dokumentuara.

VIII. SHQYRTIMI DHE MIRATIMI I REZULTATEVE PARAPRAKE

Në përfundim të shqyrtimit, KVA-ja do të diskutojë dhe miratojë rezultatet paraprake të vlerësimit, mbi bazën e dokumentacionit dhe evidencave të paraqitura.

Tabela e vlerësimit do të reflektojë rezultatet e shqyrtuara dhe të miratuara nga KVA-ja.

Përgjegjës: Anëtarët e KVA-së / AMVV.
Dokumentacioni: Vlerësimi Paraprak (**Aneksi Nr. 7**)
Rezultati: Rezultatet paraprake të miratuara nga KVA-ja.

IX. MBAJTJA DHE MIRATIMI I PROCESVERBALIT

Në përfundim të mbledhjes do të përgatitet procesverbali, ku do të pasqyrohen çështjet e trajtuara, diskutimet kryesore, vendimmarrjet dhe hapat e mëtejshëm të dakordësuar nga KVA-ja.

Procesverbali do të administrohet nga AMVV/Sekretariati Teknik dhe do t'u nënshtrohet miratimit sipas procedurës së përcaktuar.

Përgjegjës: Sekretariati Teknik.
Dokumentacioni: Procesverbali i mbledhjes dhe shkresa përcjellëse bashkive (**Aneksi Nr. 8**).
Rezultati: Procesverbali i përgatitur dhe i publikuar.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA
MINISTËR SHTETI PËR PUSHTETIN VENDOR
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E VETËQEVERISJES VENDORE

X. ADMINISTRIMI I ANKESAVE

AMVV administron komentet dhe vërejtjet dërguara nga bashkitë me shkresë dhe email, sipas udhëzimit, brenda afatit 3 (tre) ditë lidhur me vlerësimin e treguesit përkatës.

Do të përcaktohen dhe dokumentohen afatet përkatëse, si dhe mënyra e administrimit të ankesave në regjistrin përkatës.

Përgjegjës: Sekretariati Teknik.
Dokumentacioni: Regjistri i Ankesave (**Aneksi Nr. 9**).
Rezultati: Përcjellja e Ankesave pranë KVA-së.

XI. NJOFTIMI I BASHKIVE DHE PUBLIKIMI

Pas përfundimit të procedurave të mbledhjes, AMVV do të përgatisë njoftimin për bashkitë lidhur me rezultatet dhe hapat e mëtejshëm të procesit.

Informacioni përkatës do të publikohet edhe në website-in zyrtar të AMVV-së (<https://qeverisjavendore.gov.al/perfomanca-dhe-qeverisja-e-mire/granti-i-bazuar-ne-performance/rreth-grantit/2026-2/>), në përputhje me procedurat e përcaktuara për informimin dhe transparencën e procesit.

Përgjegjës: Sekretariati Teknik.
Dokumentacioni: Shkresa/email-et dhe rezultatet e vlerësimit përfundimtar (**Aneksi Nr.10**).
Rezultati: Njoftimi i bashkive dhe publikimi i informacionit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA
MINISTËR SHTETI PËR PUSHTETIN VENDOR
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E VETËQEVERISJES VENDORE

ANEKSI NR. 1

ANËTARËT E KVA - GBP 2026

Treguesi i Komponentit I: Plani i Mbarështimit të Pyjeve dhe
Treguesi i Komponentit II % e riciklimit të të ardhurave nga ekonomia pyjore të realizuara
me planifikimin/fakt në këtë sektor është jo më e vogël se 70% për vitin 2025

Nr.	Institucioni	Emër	Mbiemër	Pozicioni
1	MSHPV	Indri	Dyrmishi	Këshilltar
2	MF	Fran	Brahimi	Drejtor, Drejtoria e Financave Vendore
3	MM	Ylli	Hoxha	Përgjegjës /Sektori i Pyjeve dhe Kullotave

Treguesi i Komponentit I: Plani vendor i Menaxhimit të Mbetjeve dhe
Treguesi i Komponentit II: Gjatë vitit 2025 bashkia ka mbuluar të paktën 50% të kostos së
shërbimit të menaxhimit të mbetjeve nga tarifa (raporti tarifa e mbledhur / kosto e shpenzuar).

Nr.	Institucioni	Emër	Mbiemër	Pozicioni
1	MSHPV	Indri	Dyrmishi	Këshilltar
2	MF	Fran	Brahimi	Drejtor, Drejtoria e Financave Vendore
3	MM	Betilda	Ahmeti	Specialist në Drejtorinë e Ekonomisë Qarkulluese

Treguesi i Komponentit I: Plani Social Vendor

Nr.	Institucioni	Emër	Mbiemër	Pozicioni
1	MSHPV	Indri	Dyrmishi	Këshilltar
2	MF	Fran	Brahimi	Drejtor, Drejtoria e Financave Vendore
3	MSHMS	Nertila	Topulli	Drejtor, Drejtoria e Politikave të Përkujdesjes Sociale dhe Shërbimeve Sociale të Integruara

Treguesi i Komponentit II: Deri në 30 qershor 2026, bashkitë e vogla do të shtojnë 1 shërbim
social, bashkitë e mesme: 2 shërbime sociale dhe bashkitë e mëdha: 3 shërbime sociale

Nr.	Institucioni	Emër	Mbiemër	Pozicioni
1	MSHPV	Indri	Dyrmishi	Këshilltar
2	MF	Fran	Brahimi	Drejtor, Drejtoria e Financave Vendore
3	MSHMS	Xhilda	Papajani	Përgjegjës / Shërbimet Sociale



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA
MINISTËR SHTETI PËR PUSHTETIN VENDOR
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E VETËQEVERISJES VENDORE

Treguesi i Komponentit I: Plani Vendor për Arsimin Parauniversitar dhe
Treguesi i Komponentit II: Shkalla e regjistrimit në kopshtet publike është jo më e vogël se
60% për vitin 2025

Nr.	Institucioni	Emër	Mbiemër	Pozicioni
1	MSHPV	Indri	Dyrmishi	Këshilltar
2	MF	Fran	Brahimi	Drejtor, Drejtoria e Financave Vendore
3	MA	Englantina	Killo	Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve të Përgjithshme

Treguesi i Komponentit I: Plani Vendor për Barazinë Gjinore

Nr.	Institucioni	Emër	Mbiemër	Pozicioni
1	MSHPV	Indri	Dyrmishi	Këshilltar
2	MF	Fran	Brahimi	Drejtor, Drejtoria e Financave Vendore
3	MSHMS	Etleva	Sheshi	Drejtor, Drejtoria e Barazisë Gjinore

Treguesi i Komponentit II: Paketa e emergjencës për viktimat e dhunës është planifikuar në
buxhetin e bashkisë për vitin 2026

Nr.	Institucioni	Emër	Mbiemër	Pozicioni
1	MSHPV	Ledjon	Shahini	Këshilltar
2	MF	Fran	Brahimi	Drejtor, Drejtoria e Financave Vendore
3	MSHMS	Xhenson	Cela	Specialist / Barazia Gjinore

Treguesi i Komponentit I: Plani Vendor i Integritetit dhe
Treguesi i Komponentit II: Bashkia ka zbatuar gjatë vitit 2025 të paktën 50% të masave të
parashikuara në Planin Vendor të Integritetit për vitin 2025

Nr.	Institucioni	Emër	Mbiemër	Pozicioni
1	MSHPV	Indri	Dyrmishi	Këshilltar
2	MF	Fran	Brahimi	Drejtor, Drejtoria e Financave Vendore
3	MAPA/DPA	Rovena	Pregja	Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit

Treguesi i Komponentit II: Bashkia ka raportuar të dhënat përkatëse për të gjithë treguesit e
Raportit Kombëtar të Performancës 2025 brenda afatit të përcaktuar në udhëzim

Nr.	Institucioni	Emër	Mbiemër	Pozicioni
1	MSHPV	Indri	Dyrmishi	Këshilltar
2	MF	Fran	Brahimi	Drejtor, Drejtoria e Financave Vendore
3	AMVV	Olta	Caca	Drejtor, Drejtoria e Statistikave dhe Performancës



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA
MINISTËR SHTETI PËR PUSHTETIN VENDOR
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E VETËQEVERISJES VENDORE

Tregues të Komponentit II: Detyrimet e Prapambetura, Shlyerja e Detyrimeve, Taksa mbi pasurinë e paluajtshme

Nr.	Institucioni	Emër	Mbiemër	Pozicioni
1	MSHPV	Indri	Dyrmishi	Këshilltar
2	MF	Fran	Brahimi	Drejtor, Drejtoria e Financave Vendore
3	MF	Elidona	Durmishi	Përgjegjës Sektori

ANEKSI NR. 2



AGJENDA

Mbledhja e parë e Komisionit të Vlerësimit të Aplikimeve mbi GBP 2026

Datë: 8 Shtator 2026

Ora: 13:00 – 16:00

Vendi: Salla Albanologjia, Pallati i Kongreseve, Tiranë

12:30 - 13:00 Regjistrimi i pjesëmarrësve

13:00 – 13:20
Fjala e hapjes
Z. Ervin Demo, Ministër Shteti për Pushtetin Vendor (TBC)
Z. Fran Brahimi, Përfaqësues nga Ministria e Financave
Përfaqësues nga Ambasada e Zvicrës dhe Ambasada e Suedisë

13:20 – 13:45
Konstituimi i KVA
Përfaqësues i Ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor, Kryetar KVA
Prezantim i bazës ligjore dhe afateve sipas udhëzimit

13:45 – 14.00
Paraqitja e dokumentacionit nga AMVV
Procedurat Standarde të Veprimit
Nënshkrimi deklaratave



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA
MINISTËR SHTETI PËR PUSHTETIN VENDOR
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E VETËQEVERISJES VENDORE

ANEKSI NR. 3

DEKLARATA E KONFLIKTIT TË INTERESIT

Unë, i nënshkruari _____, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Aplikimeve për Grantin e Bazuar në Performancë, caktuar sipas përcaktimeve të Udhëzimit të përbashkët nr. 1, datë 10.6.2026 *“Për kriteret, procedurat, treguesit për shpërndarjen e fondit të grantit të bazuar në performancë, për bashkitë, për vitin 2026”*, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë ligjore dhe morale se:

Jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të përcaktuara në ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005 *“Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike”* i ndryshuar, si dhe në aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive si dhe të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 *“Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”*, të ndryshuar, të pikës 11 të nenit 15 dhe pikës 6 të Aneksit 9 të ligjit nr. 87/2025 *“Për Buxhetin e vitit 2026”*, si dhe të ligjit nr. 114/2024, *“Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor, dhe Qeverisë së Konfederatës Zvicerane, përfaqësuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, që vepron nëpërmjet Ambasadës së Zvicrës në Shqipëri, për Projektin “Bashki të forta (BTF), faza 2”*.

Në përputhje me to, deklaroj se nuk jam në kushtet e konfliktit të interesit sikurse parashikohet në dispozitat e ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 *“Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”*, i ndryshuar, dhe legjislacionin e zbatueshëm në fuqi.

Vendi dhe data

Emër Mbiemër Nënshkrimi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA
MINISTËR SHTETI PËR PUSHTETIN VENDOR
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E VETËQEVERISJES VENDORE

ANEKSI NR. 4

DEKLARATË KONFIDENCIALITETI

Unë, i nënshkruari _____, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Aplikimeve për Grantin e Bazuar në Performancë, caktuar sipas përcaktimeve të Udhëzimit të përbashkët nr. 1, datë 10.6.2026 *“Për kriteret, procedurat, treguesit për shpërndarjen e fondit të grantit të bazuar në performancë, për bashkitë, për vitin 2026”*, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë ligjore dhe morale se:

1. Marr përgjegjësinë të mos përdor dhe të mos i transmetoj personave të paautorizuar të dhëna apo informacione konfidenciale në lidhje me ose të marra gjatë procesit të vlerësimit të aplikimeve për matjen e performancës së 61 bashkive në Shqipëri, përveç nëse autorizohem shprehimisht nga titullari i institucionit, ose kërkohet me ligj. Unë e kuptoj se ky detyrim vlen gjatë afatit të punësimit si dhe pas përfundimit të tij.
2. U informova se përdorimi dhe zbulimi i të dhënave që lidhet me procesin e matjes së performancës së 61 bashkive në Shqipëri, është objekt i rregullimit nga legjislacioni në fuqi për mbrojtjen e të dhënave. Për sa më sipër, Unë nuk do të përdor ose përhap asnjë të dhënë personale që marr dijeni gjatë ushtrimit të detyrës së anëtarit të komisionit të vlerësimit për ndonjë qëllim që është në kundërshtim me qëllimet e kësaj detyre.
3. U informova se jam i detyruar të ruajë konfidencialitetin për të dhënat dhe t'i mbajë ato të sigurta, duke marrë të gjitha masat organizative dhe teknike të përshtatshme.
4. Marr përgjegjësinë e plotë që në qoftë se konstatohet që kam vepruar në kundërshtim me parashikimet për konfidencialitetin e të dhënave apo në rast të mosruajtjes së tyre, ndaj meje të merren masa të menjëhershme.

Vendi dhe data

Emër Mbiemër Nënshkrimi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA
MINISTËR SHTETI PËR PUSHTETIN VENDOR
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E VETËQEVERISJES VENDORE

ANEKSI NR. 5

MEMO

Lënda: Procesverbal mbi shqyrtimin e dokumentacionit nga AMVV mbi treguesin _____ në kuadër të GBP 2026.

Drejtuar: Anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Aplikimeve për treguesin _____.

INFORMACION I PËRGJITHSHËM

Bazuar në Udhëzimin e Përbashkët Nr. 1, Datë 10.6.2026 “Për kriteret, procedurat, treguesit për shpërndarjen e fondit të grantit të bazuar në performancë, për bashkitë, për vitin 2026”, AMVV në rolin e Sekretariatit Teknik është vënë në dispozicion me informacionin për treguesin _____.

REZULTATET E SHQYRTIMIT

_____ bashki kanë aplikuar për _____.

Bashkitë aplikuese për _____ janë: _____.

Lidhur me kontrollin e plotësisë së dokumentacionit të treguesit _____:

- **Plani Vendor _____ i miratuar nga Këshilli Bashkiak përkatës në periudhën 17 shtator 2025 - 24 korrik 2026;**
 - a) Nga ____ aplikime, rezultojnë ____ **bashki** të cilat kanë një plan _____ të miratuar nga Këshilli Bashkiak në periudhën **17 shtator 2025 - 24 korrik 2026**.

Në përputhje me Udhëzimin e Përbashkët, miratimi nga Këshilli Bashkiak, në periudhën 17 shtator 2025 - 24 korrik 2026, përbën kriterin themelor për konsiderimin e treguesit si të përmbushur.

Në mbështetje të kriterit themelor për miratimin e _____ në periudhën 17 shtator 2025 - 24 korrik 2026, verifikimet e mëposhtme janë kryer për bashkitë që ju është miratuar plani vendor, përkatësisht: _____.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA
MINISTËR SHTETI PËR PUSHTETIN VENDOR
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E VETËQEVERISJES VENDORE

Verifikimi që kryen AMVV:

1. Dokumenti i planit dorëzuar nga bashkia përkatëse:
 - a) ____ bashkitë kanë dorëzuar **dokumentin e planit**;
2. Vendimi i Këshillit Bashkiak:
 - b) ____ bashkitë kanë dorëzuar **VKB-në** në përputhje me kriterin;
3. Akti i konfirmimit të VKB-së nga Prefekti:
 - c) ____ **bashki** kanë përcjellë **aktin e konfirmimit të VKB-së nga Prefekti**.

KONKLUZIONET PARAPRAKE MBI KRITERIN E PLOTËSISË

- Totali i aplikimeve → ____ **bashki**
- VKB (brenda afatit) → ____ **bashki**
- Dokumenti i Planit (brenda afatit) → ____ **bashki**
- Akti konfirmimit nga Prefekti → ____ **bashki**

Konkluzionet e deritanishme, janë subjekt vlerësimi dhe verifikimi përfundimtar nga Komisioni i Vlerësimit të Aplikimeve, gjithashtu duke përfshirë dhe kriterin e cilësisë së planit, përkatësisht: Plani _____ duhet të jetë në përputhje me kriteret e cilësisë në Ankesin 3.

Përmbledhje tabelare e dokumentacionit të disponuar nga bashkitë

Nr.	Bashkia	Dokumenti i Planit	VKB (17 shtator 2025 – 24 korrik 2026)	Akti i Prefektit	3 Kriteret
1		✓	✗	✓	✗
2		✓	✓	✗	✗
3		✓	✓	✓	✓
4		✗	✓	✓	✓



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA
MINISTËR SHTETI PËR PUSHTETIN VENDOR
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E VETËQEVERISJES VENDORE

ANEKSI NR. 6

UDHËZIMI I PËRBASHKËT Nr. 1, datë 10.6.2026 "PËR KRITERET, PROCEDURAT, TREGUESIT
PËR SHPËRNDARJEN E FONDIT TË GRANTIT TË BAZUAR NË PERFORMANCË, PËR
BASHKITË, PËR VITIN 2026"

Dokumentacioni i dorëzuar nga Bashkitë për Planin e _____						Verifikimi nga AMVV Po/Jo	Vlerësimi i KVA Po/Jo
Nr.	Bashkia	Shkresa e Dorëzimit të Dokumentacionit	Dokumentacioni i Kërkuar (Aneksi 2 i Udhëzimit)				
			Dokumenti i Planit	VKB për miratimin e planit	Urdhëri MM-së për miratimin e planit		
1							
2							
3							
4							
5							
6							
7							
8							
9							
10							



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA
MINISTËR SHTETI PËR PUSHTETIN VENDOR
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E VETËQEVERISJES VENDORE

ANEKSI NR. 7

Vlerësimi paraprak i KVA për _____ në kuadër të GBP 2026

Dokumentacioni i dorëzuar nga bashkitë për _____		
Nr.	Bashkia	Kriteret e cilësisë
		Kualifikohet dhe në përputhje me udhëzimin
1		
2		
3		
4		
5		
6		
7		
8		

Kryetar Komisioni

Vlerësimi paraprak i KVA për _____ në kuadër të GBP 2026

Dokumentacioni i dorëzuar nga bashkitë për _____		
Nr.	Bashkia	Kriteret e cilësisë
		Kualifikohet dhe në përputhje me udhëzimet/kërkesat e MM
1		
2		
3		
4		
5		
6		
7		
8		

Anëtar Komisioni



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA
MINISTËR SHTETI PËR PUSHTETIN VENDOR
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E VETËQEVERISJES VENDORE

ANEKSI NR. 8

PROCESVERBAL

**MBLEDHJA E ____ E KOMISIONIT TË VLERËSIMIT TË APLIKIMEVE (KVA)
PËR GBP 2026**

- **HAPJA E MBLEDHJES**
- **KONKLUZIONET PARAPRAKE MBI KRITERIN E PLOTËSISË**
 - Totali i aplikimeve →
 - Dokumenti i Planit →
 - Vendimi i Këshillit Bashkiak →
 - Akti konfirmimit nga Prefekti →

Tabela Tip

Nr.	Bashkia	Dokumenti i Planit	VKB (17 shtator 2025 – 24 korrik 2026)	Akti i Prefektit	3 Kriteret
1		✓	✗	✓	✗
2		✓	✓	✗	✗
3		✓	✓	✓	✓
4		✗	✓	✓	✓

- **ZHVILLIMI I DISKUTIMEVE**

VERIFIKIMI SIPAS SUGJERIMEVE TË KVA-SË.

- Totali i aplikimeve →
- Dokumenti i Planit →
- Vendimi i Këshillit Bashkiak →
- Akti konfirmimit nga Prefekti →

Vlerësimi paraprak nga KVA mbi kualifikimin e bashkive për _____



Vlerësimi paraprak i KVA-së për _____		
Nr.	Bashkia	Kualifikohet dhe në përputhje me kriterin e cilësisë sipas udhëzimit
1		
2		
3		
4		
5		
6		
7		
8		
9		
10		

ANEKSI NR. 9

**REGJISTRI I ANKESAVE
PËR VLERESIMET PARAPRAKE TË KVA, NË KUADER TË GBP 2026**

[illegible]



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA
MINISTËR SHTETI PËR PUSHTETIN VENDOR
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E VETËQEVERISJES VENDORE

ANEKSI NR. 10

Vlerësimi përfundimtar i KVA për _____ në kuadër të GBP 2026

Dokumentacioni i dorëzuar nga bashkitë për _____		
Nr.	Bashkia	Kriteret e cilësisë
		Kualifikohet dhe në përputhje me udhëzimin
1		
2		
3		
4		
5		
6		
7		
8		

Kryetar Komisioni

Vlerësimi përfundimtar i KVA për _____ në kuadër të GBP 2026

Dokumentacioni i dorëzuar nga bashkitë për _____		
Nr.	Bashkia	Kriteret e cilësisë
		Kualifikohet dhe në përputhje me udhëzimet/kërkesat e MM
1		
2		
3		
4		
5		
6		
7		
8		

Anëtar Komisioni